



KTV
Berat BICAJ
Drejtor
Prishtinë

Ankesa Nr. 2019/72 KPM vs KTV
Ref:19110/1229/KPM/mf

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2019/72– Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kundër KTV (Palë Përgjegjëse)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-073, përmes të cilit përcaktohet sjellja e ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale gjatë fushatës zgjedhore. Duke u bazuar në kapitullin e VIII të këtij Ligji, KPM ka nxjerrë udhëzuesin për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtim me Ligjin për Zgjedhje dhe Kodin e Etikës KKPM 2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës si dhe Rregulloren për Komunikimet Komerciale audiovizuale KPM 2017/07.
2. Me datë 19 shtator 2019, KPM i ka dërguar Palës Përgjegjëse Udhëzuesin për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073. Qëllimi i dërgimit të udhëzuesit ka qenë që të licencuarve t’ju ofrohen udhëzime për respektimin e dispozitave ligjore gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore.
3. KPM bazuar në raportin e monitorimit të datës 24 shtator 2019, ka gjetur se Pala Përgjegjëse është gjetur në shkelje pasi që gjatë trasmetimit të emisionit "Rubikon" ka pas sponsorizim dhe vendosje te produkteve duke vepruar në kundërshtim me nenin 14, paragrafi 3 dhe nenin 15, paragrafi 1, të Rregullores për Komunikimet Komerciale audiovizuale KPM 2017/07.
4. KPM, pas të gjeturave nga monitorimi me datën 25 shtator 2019 i ka dërguar Palës Përgjegjëse Njoftim për shkelje, me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe i ka kërkuar të veprojnë në Rregulloren për Komunikimet Komerciale audiovizuale 2017/07. Poashtu, i ka ofruar mundësinë që brenda afatit prej tre (3) ditësh, pas pranimi të shkresës, të përgjigjet dhe të ofrojë sqarim në raport me shkeljet e gjetura.

5. KPM, me datën 27 shtator 2019 ka pranuar një përgjigje nga Pala Përgjegjëse duke kundërshtuar shkeljet e gjetura dhe se është bërë kategorizimi dhe klasifikimi i gabueshem i natyrës së emisionit Rubikon, duke e cekur se emisioni Rubikon nuk është emision i lajmeve dhe i çështjeve aktuale.
6. KPM me datën 25 shtator deri me 6 tetor 2019, ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse dhe në bazë të raportit të monitorimit të datës 8 tetor 2019, ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka transmetuar spot reklamues politik në të cilin ishin të përfshirë fëmijët, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 9 paragrafi 7 i Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
7. KPM, bazuar në raportin e monitorimit, të datës 8 tetor 2019, gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore ka gjetur se Pala Përgjegjëse gjatë emisionit “Rubikon” dhe “Interaktiv” ka pasur sponsorizim të programit dhe vendosje të produkteve të cilat sipas nenit 14, paragrafi 3 dhe nenit 15, paragrafi 1, të Rregullores për Komunikimet Komerciale audiovizuale KPM 2017/07 nuk është e lejuar në programe të tilla.

Analiza Ligjore

8. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse, ka bërë shkelje të nenit 9 paragrafi 7 i Kodit të Etikës KKPM-2016/03, nenit 14, paragrafi 3 dhe nenit 15, paragrafi 1, të Rregullores për Komunikime Komerciale KPM2017/07.

Neni 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, përcakton se:

“Nuk lejohet përdorimi dhe prezenca e fëmijëve në spotet e ndryshme promovuese të partive politike.”

9. Bazuar në raport të monitorimit KPM ka konstatuar se Pala Përgjegjëse ka transmetuar spot reklamues politik në të cilin spot ishin të përfshirë fëmijët, duke bërë kështu shkelje të nenit 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Nenin 14 paragrafi 3 i Rregullores për Komunikimet Komerciale KPM 2017/07 përcakton se:

“Programet e lajmeve dhe ato të çështjeve aktuale nuk do të sponsorizohen”.

Nenin 15 paragrafi 1 i Rregullores për Komunikimet Komerciale KPM 2017/07 përcakton se:

“Vendosja e produkteve do të ndalohet.”

10. Bazuar në raportet e monitorimit KPM ka konstatuar se Pala Përgjegjëse gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore gjatë emisionit “Rubikon” dhe “Interaktiv” ka pasur sponsorizim të programit dhe vendosje të produkteve duke vepruar në kundërshtim me nenin 14, paragrafi 3 dhe nenin 15, paragrafi 1, i Rregullores për Komunikimet Komerciale audiovizuale KPM 2017/07.

